



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 622/ prot.

Himarë, më 23.01 . 2026

Lënda: Dërgohet për miratim projektvendimi “Për ndryshime në vendimin nr.57, datë 26/11/2025”, “Për disa ndryshime në “paketën fiskale të vitit 2022”, miratuar me VKB nr.54, datë 25.11.2021, ndryshuar me VKB nr.34, datë 03.12.2024”.

KESHILLIT BASHKIAK HIMARË, ✓

Himarë

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” (i ndryshuar), ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr.132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së tatueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, të ndryshuar, VKM-së nr.319, datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, udhëzimit të Ministrit të Financave nr.32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, si dhe në zbatim të vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë nr.57, datë 26/11/2028 “Për disa ndryshime në “Paketën Fiskale të vitit 2022”, miratuar me VKB nr.54, datë 25.11.2021, ndryshuar me VKB nr.34, datë 03.12.2024”, dhe duke ju referuar relacionit nr.622prot., datë 23/01/2026 të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë;

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- Projektvendimin “Për ndryshime në vendimin nr.57, datë 26/11/2025”, “Për disa ndryshime në “paketën fiskale të vitit 2022”, miratuar me VKB nr.54, datë 25.11.2021, ndryshuar me VKB nr.34, datë 03.12.2024”.
- Relacion: Mbi projektvendimin “Për ndryshime në vendimin nr.57, datë 26/11/2025”, “Për disa ndryshime në “Paketën fiskale të vitit 2022”, miratuar me VKB nr.54, datë 25.11.2021, ndryshuar me VKB nr.34, datë 03.12.2024”

KRYETARI

Vangjel Tava





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E TË ARDHURAVE

Nr. 622/12 /prot.

Himarë, më 23.01. 2026

PROJEKT VENDIM
Nr. 5, datë 23.01.2026
PËR

**“NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.57, DATË 26/11/2025”
“PËR DISA NDRYSHIME NË “PAKETËN FISKALE TË VITIT 2022”, MIRATUAR
ME VKB NR.54, DATË 25.11.2021, NDRYSHUAR ME VKB NR.34, DATË 03.12.2024”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” (i ndryshuar), ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr.132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së tatueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, të ndryshuar, VKM-së nr.319, datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, udhëzimit të Ministrit të Financave nr.32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, si dhe në zbatim të vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë nr.57, datë 26/11/2028 “Për disa ndryshime në “Paketën Fiskale të vitit 2022”, miratuar me VKB nr.54, datë 25.11.2021, ndryshuar me VKB nr.34, datë 03.12.2024”, dhe duke ju referuar relacionit nr.622prot., datë 23/01/2026 të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë;

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë nr.57, datë 26/11/2025 “Për disa ndryshime në “Paketën Fiskale të vitit 2022”, miratuar me VKB nr.54, datë 25.11.2021, ndryshuar me VKB nr.34, datë 03.12.2024”, të bëhet ky ndryshim:

Në pikën 3 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Tabela ku paraqitet niveli i taksës sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve ndërtimore, ndryshohet si më poshtë:

Emërtimi i kategorisë së ndërtimit ose llojit të objektit të ndërtimit	ZONA A (Dhërmi, Palasë, Ilias, Vuno, Himarë, Q.Pali, Borsh, Lukovë, Piqeras, Nivicë, Shkallë, Shënavasil)	ZONA B (Kudhës, Pilur, Corraj, Fterrë, Sasaj fshat si dhe ish territori i Komunës së Horë-Vranishtit)
Ndërtime për qëllime; Objekte banimi, administrative, tregtie, shërbimi etj. që kryhen nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për qëllime turizmi, industrie apo përdorimi publik.	8 % e çmimit të shitjes për metër katror	4 % e çmimit të shitjes për metër katror

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata dhe Kryetari i Bashkisë Himarë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETARI

Vangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E TE ARDHURAVE

Nr. 622/3 prot.

Himarë, më 23.01. 2026

RELACION

PËR PROPOZIMIN E NDRYSHIMIT TË PAKETËS FISKALE VENDORE NË LIDHJE ME KLASIFIKIMIN E NDËRTIMEVE PËR EFEKT TË TAKSËS SË NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË

I. QËLLIMI I RELACIONIT

Drejtoria e te ardhurave në ushtrim të funksioneve të saj ligjore dhe bazuar ne propozimin e Drejtorise se Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit paraqet për kete relacion për ndryshimin e Paketes Fiskale te vitit 2022,miratuat me VKB nr 54 dt 25.11.2021,ndryshuar me VKB nr 57 dt 26.11.2025

II. BAZA LIGJORE

Propozimi mbështetet në:

- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar;
- Kompetencat e Kryetarit të Bashkisë për paraqitjen e projektakteve në Këshillin Bashkiak.

III. SITUATA AKTUALE

Nga aplikimet e fundvitit per leje ndertimi është konstatuar përdorimi i termit “apart-hotel” për objekte ndërtimi që përbëhen nga njësi banimi të ndara (apartamente), të cilat potencialisht destinohen për shitje individuale.

Ky term:

- krijon paqartësi mbi funksionin real të objektit (banim për shitje apo shërbim hotelerie);
- nuk përbën kategori ndërtimore të njohur nga legjislacioni në fuqi;

zhvillimin e territorit;

- përdoret kryesisht si emërtim tregtar nga subjektet zhvilluese.
- krijon hapësira për shmangie të detyrimeve fiskale, veçanërisht lidhur me kontributin për strehimin social dhe detyrime të tjera të lidhura me shitjen e njësive të banimit.

Përdorimi i këtij termi ka sjellë paqartësi në klasifikimin fiskal të ndërtimeve dhe rrezik për interpretime të ndryshme gjatë zbatimit të Paketës Fiskale.

IV. ARSYETIMI I NDRYSHIMIT

Sipas kuadrit ligjor në fuqi, ndërtimet klasifikohen:

- a. ose si ndërtime për banim për shitje;
- b. ose si ndërtime për hoteleri / turizëm.

Legjislacioni nuk njeh termin “apart-hotel” si kategori ndërtimore apo fiskale. Për rrjedhojë, vijimi i përdorimit të këtij termi:

- cenon parimin e sigurisë juridike;
- krijon vështirësi në zbatim dhe kontroll;
- ekspozon Bashkinë ndaj riskut të kontestimeve administrative dhe financiare.

V. PËRMBAJTJA E NDRYSHIMIT TË PROPOZUAR

Ndryshimi i propozuar synon ;

1. Të hiqet çdo referencë ndaj termit “apart-hotel” nga tabela e klasifikimit të investimeve ndërtimore.
2. Të përcaktohet qartë se klasifikimi për efekt të taksës së ndikimit në infrastrukturë bëhet vetëm sipas destinacionit të përcaktuar në lejen e ndërtimit, konkretisht:
 - ndërtim për banim (po ose jo) për shitje; ose
 - ndërtim për hoteleri / turizëm.
3. Në rastet e ndërtimeve me përdorim të kombinuar, përlllogaritja e taksës të kryhet sipas destinacionit real të sipërfaqeve, të ndara dhe të përcaktuara qartë në projektin dhe lejen e miratuar.
4. Të sanksionohet se emërtimet tregtare të përdorura nga subjektet zhvilluese nuk kanë efekt juridik apo fiskal, nëse nuk përputhen me destinacionin e miratuar.

VI. EFEKTET FINANCIARE DHE ADMINISTRATIVE

Ndryshimi i propozuar:

- do të kontribuojë në rritjen e transparencës
- rrit qartësinë dhe zbatueshmërinë e Paketës Fiskale Vendore;
- përmirëson sigurinë juridike;
- garanton trajtim të barabartë fiskal për subjektet.
- mbron interesin publik dhe forcon administrimin e të ardhurave të Bashkisë

VI. PËRFUNDIM

Miratimi i këtij propozimi do të kontribuojë në rritjen e transparencës, sigurisë juridike dhe zbatimit të njëtrajtshëm të legjislacionit fiskal vendor, duke mbrojtur interesin publik dhe duke forcuar administrimin e të ardhurave të Bashkisë Himarë.

DREJTORIA E FINANCES DHE E PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT

DREJTORI

Besa Xhaferi



DREJTORIA E TË ARDHURAVE

DREJTORI

Flobens Dilaveri



DREJTORIA JURIDIKE

DREJTORI

Ardir Muhametaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 622 prot.

Himarë, më 24.01 . 2026

RELACION

PËR PROPOZIMIN E NDRYSHIMIT TË PAKETËS FISKALE VENDORE NË LIDHJE ME
KLASIFIKIMIN E NDËRTIMEVE PËR EFEKT TË TAKSËS SË NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË

KRYETARIT

(KËTU)

I. QËLLIMI I RELACIONIT

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT), në ushtrim të funksioneve të saj ligjore, paraqet për shqyrtim pranë Kryetarit të Bashkisë Himarë propozimin për ndryshimin e Paketës Fiskale Vendore, konkretisht të klasifikimit të ndërtimeve për efekt të përlogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, përmes heqjes së termit “apart-hotel” dhe qartësimit të kriterëve ligjore të klasifikimit.

II. BAZA LIGJORE

Propozimi mbështetet në:

- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar;
- Kompetencat e Kryetarit të Bashkisë për paraqitjen e projektakteve në Këshillin Bashkiak.

III. SITUATA AKTUALE

Nga shqyrtimi i aplikimeve për leje ndërtimi dhe dokumentacionit teknik të administruar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, është konstatuar përdorimi i termit “apart-hotel” për objekte ndërtimi që përbëhen nga njësi banimi të ndara (apartamente), të cilat potencialisht destinohen për shitje individuale.

Ky term:

- krijon paqartësi mbi funksionin real të objektit (banim për shitje apo shërbim hotelerie);
- nuk përbën kategori ndërtimore të njohur nga legjislacioni në fuqi;
- nuk përfaqëson destinacion funksional në kuptim të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
- përdoret kryesisht si emërtim tregtar nga subjektet zhvilluese.
- krijon hapësira për shmangie të detyrimeve fiskale, veçanërisht lidhur me kontributin për strehimin social dhe detyrime të tjera të lidhura me shitjen e njësive të banimit.

Përdorimi i këtij termi ka sjellë paqartësi në klasifikimin fiskal të ndërtimeve dhe rrezik për interpretime të ndryshme gjatë zbatimit të Paketës Fiskale.

IV. ARSYETIMI I NDRYSHIMIT

Sipas kuadrit ligjor në fuqi, ndërtimet klasifikohen:

- a. ose si ndërtime për banim për shitje;
- b. ose si ndërtime për hoteleri / turizëm.

Legjislacioni nuk njeh termin “apart-hotel” si kategori ndërtimore apo fiskale. Për rrjedhojë, vijimi i përdorimit të këtij termi:

- cenon parimin e sigurisë juridike;
- krijon vështirësi në zbatim dhe kontroll;
- ekspozon Bashkinë ndaj riskut të kontestimeve administrative dhe financiare.

V. PËRMBAJTJA E NDRYSHIMIT TË PROPOZUAR

DPZHT propozon që në Paketën Fiskale Vendore të Bashkisë Himarë:

1. Të hiqet çdo referencë ndaj termit “apart-hotel” nga tabela e klasifikimit të investimeve ndërtimore.
2. Të përcaktohet qartë se klasifikimi për efekt të taksës së ndikimit në infrastrukturë bëhet vetëm sipas destinacionit të përcaktuar në lejen e ndërtimit, konkretisht:
o ndërtim për banim (po ose jo) për shitje; ose
o ndërtim për hoteleri / turizëm.
3. Në rastet e ndërtimeve me përdorim të kombinuar, përlllogaritja e taksës të kryhet sipas destinacionit real të sipërfaqeve, të ndara dhe të përcaktuara qartë në projektin dhe lejen e miratuar.
4. Të sanksionohet se emërtimet tregtare të përdorura nga subjektet zhvilluese nuk kanë efekt juridik apo fiskal, nëse nuk përputhen me destinacionin e miratuar.

VI. EFEKTET FINANCIARE DHE ADMINISTRATIVE

Ndryshimi i propozuar:

- nuk sjell kosto shtesë për buxhetin e Bashkisë;
- do të kontribuojë në rritjen e transparencës
- rrit qartësinë dhe zbatueshmërinë e Paketës Fiskale Vendore;
- përmirëson sigurinë juridike;
- garanton trajtim të barabartë fiskal për subjektet.
- mbron interesin publik dhe forcon administrimin e të ardhurave të Bashkisë

VI. PËRFUNDIM

Miratimi i këtij propozimi do të kontribuojë në rritjen e transparencës, sigurisë juridike dhe zbatimit të njëtrajtshëm të legjislacionit fiskal vendor, duke mbrojtur interesin publik dhe duke forcuar administrimin e të ardhurave të Bashkisë Himarë.

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DREJTORI

Klodi Ajazaj

**Klodi
Ajazaj**

Digitally signed by Klodi
Ajazaj
Date: 2026.01.23
12:26:49 +02'00'